



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1167 Prot.

Durrës më 24/09/2020

V E N D I M

Nr. 7 Datë 24/09/2020

Për miratimin e Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor të Universitetit "Aleksandër Moisiu Durrës"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit Nr.112 datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e grades Shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar me vendimin Nr.808 datë 11.12.2019 "Për ndryshime në vendimin nr.12. date 23.2.2018 për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e grades Shkencore "Doktor" dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", vendimin Nr.777 datë 26.12.2018 "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore"

V E N D O S I:

1. Për miratimin e Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - K/ Këshillit të Etikës
  - Drejtuesit e Njësive Kryesore të Fakulteteve
  - Administratorit
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R  
Prof. Dr. *Kseanela SOTIROFSKI*

# **KODI I ETIKËS NË KËRKIM SHKENCOR**

## **Neni 1**

### **Baza Ligjore**

Ky Kod është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhur me të”, të Ligjit nr. 9131 datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", të Ligjit 9367 datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, të Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Kodit Etikës së UAMD, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me fushën e veprimit të këtij kodi.

## **Neni 2**

### **Objekti**

Kodi i Etikës në Kërkimin Shkencor në UAMD, përmban parimet dhe normat themelore të sjelljes të studentevë dhe të personelit akademik dhe kërkues shkencor që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Universitet apo që përdorin në punimet dhe publikimet e tyre, cilësimin si pjesë përbërse e tij.

## **Neni 3**

### **Qëllimi**

1. Qëllimi i Kodit Etikes në Kërkimin Shkencor është përcaktimi i bazës ligjore dhe të një kornize vetërregulluese për ushtrimin dhe mbajtjen e përgjegjësive ligjore, institucionale, profesionale, morale e shoqërore të stafit akademik, kërkimor shkencor dhe studentëve të UAMD.
2. Kodi i Etik në Kërkimin Shkencor synon të ruajë, të garantojë dhe të mbrojë pastërtinë dhe integritetin akademik, profesional, institucional dhe moral të veprimtarisë akademike e kërkimore-shkencore, në përputhje me standardet ndërkombëtare bashkëkohore të veprimtarisë akademike dhe të kërkimit shkencor.

## **Neni 4**

### **Fusha e zbatimit**

Kodi i Etikes në Kërkimin Shkencor zbatohet gjatë kërkimit në të gjitha fushat e veprimtarisë kërkimore dhe akademike, të shkencës, të djes e kërkimit dhe është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë studentet e të tre cikleve të studimit dhe nga i gjithë personeli akademik dhe kërkimor-shkencor në universitet. Ai përfshin veprimtarine kerkimore te studenteve ne zhvillimin e projekteve te kursit, temave të diplomave te tre cikleve te studimit, studimeve te doktoratures, teksteve dhe botimeve që mbajnë autorësinë e UAMD-së dhe veprimtarise kerkimore shkencore te personelit akademik.

## **Neni 5**

## **Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë kod kanë kuptimet si më poshtë:

1. “Bashkautorësia” është kryerja e një punimi në grup, me më shumë se një anëtar.
3. “Fabrikimi” është sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta.
4. “Falsifikimi” është manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/ose proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja a shmangia e të dhënave ose e rezultateve, në mënyrë të pajustificuar ose prezantimi i një punimi ose botimi si me vlera shkencore, pa qenë i tillë.
5. “Kërkimi shkencor” është një ndërmarrje individuale apo e përbashkët, që synon arritje të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë.
6. Kërkimi themelor, quhet puna origjinale teorike apo eksperimentale për përfitimin e njohurive të reja, pa pasur si synim të drejtperdrejtë ndonjë zbatim apo përdorimin praktik të sajë.
7. Kërkim i zbatuar, quhet puna kërkimore shkencore origjinale e ndërmarrë për të zgjidhur problem specifikë të përdorimit praktik.
8. Veprimtari kërkimore, quhet kërkimi llogjik dhe sistematik i informacioneve të reja dhe të dobishme synim gjetjen e përgjigjeve për pyetjet që lindin, dhe të zgjidhjeve të problemeve në fusha të ndryshme të shkencës, nëpërmjet analizave objektive dhe përdorimit të metodologjisë së duhur shkencore.
9. “Liria akademike dhe e kërkimit shkencor” është e drejta për të përcaktuar çështjet akademike dhe të kërkimit, për të zhvilluar teori, për të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme kërkimore në mënyrë të pavarur dhe pa ndikime që nuk lidhen me kërkimin.
10. “Parimet e kërkimit shkencor” janë parimet që orientojnë kërkuesit në veprimtarinë kërkimore.
11. “Përgjegjësia akademike e kërkimore” është detyrimi për të zbatuar parimet, normat, standardet dhe kriteret e etikës së kërkimit në institucionet e arsimit të lartë dhe ato kërkimore.
12. “Plagjiatura” është përdorimi i ideve dhe punës së të tjerëve si të vetat, pa cituar burimin origjinal, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.
13. “Procedurat e kërkimit shkencor” përfshijnë pyetjet kërkimore, hipotezat, analizën, formulimin e rekomandimeve, përdorimin e burimeve dhe raportimin e rezultateve të kërkimit shkencor.
14. “Sanksionet” janë masat disiplinore dhe penalizuese që merren ndaj subjekteve që kryejnë shkelje të integritetit në kërkimin shkencor.

## **Neni 6**

### **Liria akademike dhe parimet e kërkimit shkencor**

1. Veprimtaria akademike dhe kërkimi shkencor ngrihen mbi lirinë akademike, e cila garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar çështjet akademike dhe të kërkimit, për të zhvilluar teori, për

të grumbulluar të dhëna empirike dhe për të përdorur metoda të përshtatshme. Veprimtaria akademike dhe kërkimi shkencor zhvillohen në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim negativ mbi kërkimin dhe rezultatet e tij si edhe nga ndikimet ideologjike, politike, ekonomike, teknologjike, ose nga ndryshimet në mjedisin e kërkimit.

2. Parimet themelore të integritetit të kërkimit shkencor orientojnë studentët dhe personelin akademik në punën e tyre dhe në angazhimin ndaj sfidave praktike, etike dhe intelektuale që shoqërojnë ose burojnë nga kërkimi shkencor. Këto parime janë:

- a) garancia për cilësinë e kërkimit;
- b) ndershmëria në zhvillimin dhe në komunikimin e rezultateve me transparencë, drejtësi dhe paanshmëri;
- c) respekti për kolegët;
- d) kujdesi për trashëgiminë kulturore dhe mjedisin;
- e) përgjegjësia shoqërore për kërkimin.

3. Kërkimi shkencor udhëhiqet nga modeli i praktikave më të mira, të cilat përfshijnë aspektet e mëposhtme:

- a) mjedisin e kërkimit;
- b) trajnimin për kërkimin;
- c) udhëheqjen e kërkimit dhe të studiuesit;
- d) procedurat e kërkimit;
- e) mbrojtjen e studiuesit;
- f) përdorimin e të dhënave;
- g) punën në skuadër dhe bashkëpunimin;
- h) botimin e rezultateve të kërkimit;
- i) vlerësimin e kërkimit.

## **Neni 7**

### **Mbikëqyrja dhe udhëheqja e kërkimit shkencor**

1. UAMD krijon kushtet dhe ofron garancitë për përditësimin teorik dhe trajnimin metodologjik të studentëve dhe stafit akademik.
2. UAMD mbështet trajnimin e studentëve dhe stafit akademik për zbatimin e normave të etikës dhe standardeve të integritetit, të pasqyruara në kodet dhe rregulloret përkatëse për kërkimin shkencor.
3. Kërkuesit më të vjetër dhe drejtuesit e kërkimit këshillojnë, mbështesin dhe nxisin zhvillimin e aftësive profesionale të kërkuesve më të rinj.

## **Neni 8**

### **Parimet e procedurave të kërkimit shkencor**

1. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat mbështeten në kontekstin dhe nevojat e zhvillimit shoqëror.

2. Studentet dhe stafi akademik duhet te bëjnë kujdesin më të madh të mundshëm për mënyrat dhe procedurat e analizës, të dokumentimit dhe të formulimit të rekomandimeve të kërkimit shkencor.

3. Rezultatet, interpretimet, përfundimet dhe rekomandimet e kërkimit shkencor publikohen të qarta, me saktësi e transparencë, duke respektuar fshehtësinë e të dhënave apo të gjetjeve kur kjo është e nevojshme ose kur kërkohet.

## **Neni 9**

### **Respekti dhe masat mbrojtëse në kërkimin shkencor**

1. Studentët dhe stafi akademik veprojnë në përputhje me kodet dhe rregulloret e disiplinave përkatëse të fushave të studimit.

2. Studentët dhe stafi akademik i trajtojnë subjektet e kërkimit, me kujdes e respekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe etike në fuqi.

3. Studentët dhe stafi akademik shmangin rreziqet dhe dëmet e mundshme që kërkimi mund të shkaktojë mbi komunitetet, individët, mjedisin, trashëgiminë historike e kulturore, si dhe perspektivat e zhvillimit në territorin ku kryejnë studimet.

## **Neni 10**

### **Përdorimi dhe ruajtja e të dhënave**

1. Studentet dhe stafi akademik, dhe UAMD mundësojnë ruajtjen e sigurt të të dhënave e të materialeve kërkimore, përfshirë ato të pabotuara, për një periudhë kohore të arsyeshme.

2. Studentet dhe stafi akademik dhe UAMD sigurojnë që qasja në të dhënat të jetë e hapur sa më shumë të jete e mundur: e gjatshme, e arritshme, ndërvepruese, transparente, e ripërdorshme. Qasja në të dhënat mund të kufizohet aq sa e vlerësojnë të nevojshme këto institucione, me qëllim që të ruajnë të dhënat mbi çështje të sigurisë së vendit ose nëse kërkohet nga financuesit e kërkimit.

3. Studentet dhe stafi akademik dhe UAMD prodhojnë të dhëna dhe produkte legjitime dhe të mundshme për t'u cituar, në bazë të standardeve nderkombetare të citimit.

4. Studentet dhe stafi akademik dhe UAMD sigurojnë që çdo kontratë a marrëveshje për publikimin ose përdorimin e rezultateve të kërkimit, të respektojë pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit.

## **Neni 11**

### **Përgjegjësia e përbashkët**

1. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet kërkimore shkencore marrin përgjegjësi për garantimin e integritetit gjatë gjithë fazave të procesit kërkimor.

2. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi qëllimet e punës kërkimore dhe komunikimin mbi procesin dhe rezultatet e kërkimit në mënyrë sa më transparente e të hapur.

3. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi standardet për integritetin e procesit kërkimor, mbi ligjet dhe rregulloret që do të zbatohen, mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit për bashkëpunëtorët, si dhe mbi procedurat e trajtimit të mosmarrëveshjeve në rastet e shkeljeve të dispozitave të Kodit të Etikës në Kërkimin Shkencor.
4. Të gjithë partnerët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi dërgimin ose jo për botim të rezultateve të kërkimit.
5. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta njohin kontributin e njëri-tjetrit si bashkautorë në të gjitha fazat e kërkimit: konceptimin, mbledhjen e të dhënave, analizën dhe interpretimin e rezultateve.
6. Bashkautorët sigurojnë që puna e secilit të jetë e arritshme për kolegët në procesin e kërkimit, në mënyrë të hapur, transparente, të saktë dhe në kohën e duhur, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet dhe vendoset ndryshe.
7. Drejtuesi shkencor ka përgjegjësi që të orientojë bashkëpunëtorët për zbatimin korrekt të kërkesave të këtij kodi.

## Neni 12

### **Monitorimi i punës kërkimore shkencore të anëtarëve të UAMD**

1. UAMD monitoron dhe verifikon nivelin e aktivitetit kërkimor shkencor të pjestarëve të tijë, jo vetëm për të matur dhe verifikuar cilësinë e këtij aktiviteti, por dhe për të garantuar efektivitetin e fondeve të përdorura në kërkim shkencor.
2. Për monitorimin e këtij procesi Senati Akademik, krijon Komisionin e Integritetit Akademik (KIA) prej pesë anëtarësh përfaqësues të Njësive Kryesore, pjese e KIA pa të drejtë vote është dhe një specialist IT. Funksionimi i KIA rregullohet me rregullore të vecantë të hartuar prej tyre dhe miratuar nga Rektori.
3. Ansambleja e personelit Akademik të Njësive Kryesore krijon Komisionin e Integritetit Akademik të Fakultetit (KIAF), të përbërë nga 5 anëtarë që zgjidhen me votim të fshehtë.
4. Universiteti, për realizimin e këtij procesi siguron për KIA dhe KIAF, softwarin e nevojshëm dhe të sigurtë, për realizimin e procesit *chek plagiarism*.
5. Punimet akademike dhe kërkimore shkencore të realizuar në Njësitë Kryesore (temat e diplomës të të gjithë cikleve të studimit, disertacionet, artikujt shkencor, monografitë) duhet të marrin certifikatën e kontrollit të plagjiaturës nga ky komision.
6. Procedura e vlerësimit antiplagjiaturë, dhe të drejtat dhe mënyra e ankimimit përcaktohen me rregullore të vecantë.

## Neni 13

### **Shkeljet e rënda të etikës në kërkimin shkencor**

Shkelje të rëndë të etikës në kërkimin shkencor përbëjnë:

- i) fabrikimi i të dhënave të përdorura, ii) falsifikimi rezultateve të studimit, iii) plagjiatura.

#### **Neni 14**

##### **Shkelje të tjera të etikës në kërkimin shkencor**

Shkelje të integritetit në kërkimin shkencor, përbëjnë praktikatat e mëposhtme:

a) manipulimi i autorësisë ose denigrimi i rolit të kërkuesve të tjerë në botime; b) ribotimi i pjesëve thelbësore të botimeve të veta më të hershme si të reja (autoplagjiatura); c) citimi përzgjedhës, me qëllim për të zmadhuar gjetjet e veta ose të redaktorëve, drejtuesve ose të kolegëve; d) fshehja e pjesëve e rezultateve të kërkimit; e) lejimi i financuesve/sponsorizuesve të rrezikojnë pavarësinë e procesit të kërkimit ose të raportimit të rezultateve, me qëllim krijimin e kuptimeve të njëanshme ose të paplota; f) zgjerimi në mënyrë të panevojshme i bibliografisë së studimit; g) akuzimi me keqdashje i studiuesve të tjerë për sjellje të papranueshme ose shkelje të tjera; h) zmadhimi i pajustificuar i rëndësisë dhe i zbatueshmërisë praktike të gjetjeve të kërkimit; i) vonimi ose pengimi i punës së kërkuesve të tjerë; j) fshehja e shkeljeve të mundshme të integritetit kërkimor të kryera nga persona të tjerë; m) fshehja e konfliktit të interesit; n) si dhe shkelje të tjera etike të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

#### **Neni 15**

##### **Konstatimet e shkeljes së etikës në kërkimin shkencor**

1. Konstatimet e shkeljeve të Etikës në kërkim shkencor mund të bëhen nga anëtarët e personelit akademik, autoritetet dhe organet drejtuese të universitetit (dekani, rektori, senati akademik, këshilli i etikës), dhe nga persona apo institucione jashtë Universitetit.
2. Në të gjitha rastet procesi verifikimit të konstatimit fillon në Departamentin ku është realizuar kërkimi shkencor. Në përfundim të verifikimit KIAF dergon në Këshillin e Etikës për shqyrtim e vendimarrje Raportin e Verifikimit.

#### **Neni 16**

##### **Sanksionet për shkelje të etikës në kërkimin shkencor**

1. Në rast se në raportin e KIAF, konstatohen shkelje të klasifikuara të rënda të etikës në kërkimin shkencor Këshilli i Etikës merr vendimin për revokimin e grades të cfarë do lloj niveli qoftë (Bsc, Master apo Doktorature), apo të efekteve të tjera për të cilat mund të jetë përdorur rezultati i kërkimit shkencor. Bashkëautorët dhe udhëheqësit shkencor, në rast se rezultatet e kërkimit nuk i kanë përdorur poë fitimin e ndonjë grade apo titulli akademik, janë bashkëpërgjegjës për efektet financiare.
2. Nëse në rastet e konstatuara nga pika 1 e këtij neni, janë financuar nga fonde shtetërore, personat përgjegjës duhet të kthejnë dëmin e shkaktuar.
3. Në rastet e konstatimit të shkeljeve të tjera të etikës në kërkim Këshilli i Etikës merr masa dhe përcakton sanksione në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **Neni 17**

### **Këshilli i Etikës**

1. Këshilli i Etikës pranë universitetit kryen procedurat e verifikimit dhe të shqyrtimit të shkeljeve të integritetit në kërkimin shkencor dhe merr vendime mbi bazën e gjetjeve, në përputhje me sanksionet e parashikuara në këtë kod.
2. Këshilli i Etikës fillon procedurën e analizimit dhe marrjes së vendimit përkatës, me mbërritjen e Raportit të Verifikimit nga ana e KIA ose KIAF.
3. Në rastet kur Nësitë Kryesore nuk veprojnë, Këshilli i Etikës me iniciativën e tij apo me kërkesë të Dekanit apo Rektorit fillon procedurën e verifikimit dhe merr vendimet përkatëse.
4. Vendimi i Këshillit të Etikës u bëhet i ditur personit të interesuar dhe Autoriteteve Drejtuese të Universitetit.
5. Me përfundimin e afateve të ankmimit, Autoritetet Drejtuese marrin masa sipas rastit, për heqjen e gradës, titullit apo për zhdëmtimin financiar.

## **Neni 18**

### **Ankmimi i vendimit të Këshilli i Etikës**

1. Vendimi i Këshillit të Etikës është përfundimtar dhe duhet zbatuar.
2. Kundra vendimit të Këshillit të Etikës mund të bëhet ankimim në gjykatë sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

## **Neni 19**

### **Dispozita të fundit**

1. Kodi i Etikës në Kërkim Shkencor hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik.
2. Rregulloret e programeve të studimit duhet të harmonizohen me dispozitat e këtij Kodi, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e tij.
3. Të drejtën për interpretimin apo ndryshimin e këtij kodi e ka Senati Akademik universitetit "Aleksander Mosiu" Durrës.